
9 KONTROLLI I NJËSUAR I AUTORËVE

Në këtë kapitull përshkruhen parimet e përgjithshme të katalogimit me kontrollin e njësuar, pjesët përbërëse të modulit COBISS3/Katalogimi (ndërfaqja për katalogim, dritarja për kërkim dhe paraqitësi) dhe procedurat e punës me regjistrimet e njësuara nga baza e të dhënave CONOR. Pjesët përbërëse të ndërfaqes, që hapet në klasën **Regjistrimi i njësuar (CONOR)**, funksionojnë sipas të njëjtave parime sikurse pjesët përbërëse në klasën **Regjistrimi bibliografik**, prandaj në këtë kapitull janë përshkruar kryesisht dallimet.

Me zbatimin e kontrollit të njësuar në sistemin e katalogimit të përbashkët ndryshon shënimi i të dhënave në fushat, për të cilat ekziston kontrolli i njësuar (shih kap. 7.3.4.1).

Në këto fusha mund të vendosni emërtimet uniforme për emrat vetjakë vetëm përmes bazës së njësuar të të dhënave, ndërsa për emrat e organizatave përmes bazës së njësuar ose në mënyrë manuale. E njëjta gjë vlen edhe për shtimin e varianteve të emërtimeve dhe emërtimeve në lidhshmëri. Përmes bazës së njësuar të të dhënave mund të ndryshohen edhe emërtimet.

Për lidhjen midis emërtimeve në regjistrimet bibliografike dhe atyre të njësuara shërben nënfusha 3 – *Numri i regjistrimit të njësuar*, ku shënohet numri identifikues i regjistrimit të njësuar. Përmes kësaj nënfushe në regjistrimin bibliografik shënohet në mënyrë automatike pikëqasja e njësuar, njëkohësisht shtohen edhe variantet e pikëqasjeve dhe pikëqasjet në lidhshmëri nga regjistrimi i njësuar. Nënfusha 3 mundëson edhe bashkërendimin automatik të mëvonshëm të regjistrimeve bibliografike me ato të njësuara (shih kap. 9.12).

Në sistemet COBISS, ku deri tani nuk ka ekzistuar kontrolli i njësuar, një numër i madh i emërtimeve në regjistrimet e vjetra bibliografike pas krijimit të tyre mund të mbeten të palidhura. Emërtimet e palidhura më vonë duhet të lidhen në mënyrë manuale me regjistrimet në bazën e duhur të njësuar të të dhënave.

Për të siguruar sa më shumë efikasitet dhe cilësi të sistemit COBISS, është e rëndësishme që regjistrimet në bazat e njësuara ekzistuese të jenë sa më të plota. Është me rëndësi që të verifikohen sa më shumë regjistrime që të jetë e mundur. Midis regjistrimeve për persona dhe organizata kanë përparësi regjistrimet për autorët vendas si dhe autorët e huaj të përfaqësuar më shpesh.

Katalogimi me kontroll të njësuar për momentin është i mundur vetëm në sistemet COBISS, të cilët në sistemin e katalogimit të përbashkët kanë përfshirë një nga bazat e njësuara të të dhënave (shih edhe kap. 2.1.2).

Nënkapitujt:

- Ndërfaqja për katalogim
- Dritarja për kërkim
- Paraqitësi
- Kujtesa e fragmenteve e regjistrimeve
- Redaktuesi i regjistrimit
- Kontrolli i njësuar
- Shkarkimi i regjistrimeve
- Krijimi i regjistrimeve
- Përmirësimi dhe plotësimi i regjistrimeve
- Regjistrimet dublikatë
- Ndarja e regjistrimeve
- Bashkërendimi i regjistrimeve bibliografike me ato të njësuara